

FATMIRA SHYTI (SHPATI)

**VLERËSIME PËR DREJTSHKRIMIN NË SHKRIMET
E GAZETËS POSTA E SHQYPNIËS**

1. Kodifikimi i gjuhës shqipe nga Komisia Letrare e Shkodrës

Në Gazetën “*Posta e Shqypniës*”, një vend të rëndësishëm zinin ngjarjet kulturore dhe shkencore.

Në kohën kur u botua gazeta, *Komisia Letrare e Shkodrës* (1916- 1917), hartoj një kod drejtshkrimor të gjuhës shqipe, duke u konsideruar kështu si pikënisje e normatizimit të shqipes së shkruar të përbashkët. Gazeta “*Posta e Shqypniës*” që në numrin e saj të parë i bëri jehonë thirrjes së *Komisisë Letrare të Shkodrës*. Përveç mendimeve të përbashkëta, në shkrimet e gazetës, kishte reagime kundër vendimeve të Komisisë Letrare.

Komisia Letrare si themel të ortografisë mori dialektin e Elbasanit, me disa përmirësime. Zbatimi i parimit fonetik është në thelb një parim demokratik i gjuhës letrare, gjë që do të thotë se gjuha letrare shqipe buron drejtpërdrejt nga populli.

Komisia Letrare vendosi parime e rregulla mbi ortografinë e gjuhës shqipe të shkruar.

- *Ortografia e gjuhës do të jetë fonetike*; d.m.th. gjuha do të shkruhet ashtu si flitet nga populli. Si themel i ortografisë do të merrej dialekti i Elbasanit me disa përmirësime.

- Të mos shënohej sasia e zanoreve përveç në librat e gjuhësisë.

- Grupet e bashkëtingëlloreve *mb*, *nd*, e *ngj*, do të shkruhen e të shqiptohen në formën e vjetër të ruajtura më mirë në dialektin e toskërishtes e në disa nëndialekte të gegërishtes. Për shembull: *rend*, *mbathë*, *nder* etj.

- Grupet e zanoreve *ie*, *ue*, *ye*, të cilat në dialektin e Elbasanit janë përmbledhur me zanoret e gjata *i:*, *u:*, *y:*. (psh *di:ll*, *mi:ll*, *ftu:*, *ly:*, etj.) do të shkruhen si janë në dialektin e toskërishtes e në disa nëndialekte të gegërishtes (*diell*, *miell*, *ftue*, *lye* etj.).

- Përdorimi i zanores *e*, në mes të fjalëve do të shkruhet “*ku e lyp etipmologjia e aty ku shqiptohet në toskërishte*”. Zanorja *ë* do të përdorej në këto pozicione në mes të fjalës: *këndue*, *shëndet*, *rryfye*, etj. në fund të fjalës, në emrat e gjinisë femërore, ku theksi bie në rrokjen e parafundit: *punë*, *mollë*, *lopë*, etj. Ruhet tek disa emra të gjinisë mashkullore për arsye të gjatësisë së zanores së theksuar si; *burrë*, *djalë*, etj. Emrat e gjinisë femërore që mbarojnë me; *ër*, *ërr*, *ull*, shkruhen pa “*ë*” fundore: *Shkodër*, *kokërr*, *vegël*, *kumbull*, etj.

Mbiemrat kryesisht me origjinë foljore, që mbarojnë me rrokje të theksuar dhe të gjatë marrin *ë* vetëm ato të gjinisë femërore: *e fortë*, *e lirë*, *e thatë*, etj.

• Komisia Letrare u mor edhe me çështje të tjera drejtshkrimore. Prireja e përemrave vetorë *unë* dhe *ti*, sidomos për rasat gjinore dhe rrjedhore të tyre. Përemrat dëftorë *ky*, *kjo*, *ai*, *ajo*, dhe përemrat e pacaktuar *secili* dhe *gjithësecili*.

Rregullat e drejtshkrimit që u vendosën, ishin të lehta, të thjeshta dhe pothuajse gjithëpërfshirëse. KLSH u dha zgjidhje shkencore problemeve kyçe të drejtshkrimit të shqipes dhe parimeve teorike mbi të cilat duhet të mbështetej ai¹.

2 Mendime të botuara në gazetën “Posta së Shqypniës”, kundër vendimeve të Komisionit Letrare

Gazeta “Posta e Shqypniës” pasqyronte gjendjen e plotë politike e kulturore të Shqipërisë e më gjërë. Kjo gazetë ka luajtur një rol të rëndësishëm për zhvillimin dhe lëmin e gjuhës së shkruar të variantit më të mirë e të përparuar të arealit gegë.

Gazeta që në muajin e parë nxori lajme për vendimet e Komisionit Letrare². Por përveç vendimeve të Komisionit Letrare, në faqet e kësaj gazete e pikërisht në rubrikën “Literaturë e harte”, botohen shkrime kundër vendimeve të saj.

Me 28 Dhetuer 1916, në rubrikën “Literaturë e harte”, botohet shkrimi i poetit Vinçens Prendushi me titull “Nji vëndim i Komisionit Letraar” ku gjejmë mendimin kundër heqjes së kuantitetit të zanoreve.

Rubrika “Literaturë e harte”, do trajtonte vazhdimisht çështje të gjuhës shqipe, e sidomos unifikimin e saj. Artikulli fillon me argumente e analiza se çfarë është një komb, duke e parë në këndvështrim politik, gjeografik dhe etnografik. “Tujë kë në qy shenjimet e para nuk kanë n’vetvedi nji karakter të plotë e qy mund t’keet qindresë, un kujtoj se gjuhë, tujë pasë, mas provëve qy kena n’dorë e mas gjygit t’dietarve, nji karakter qy nuk ndrron, ashta sheji ma i kjarti e gadigadi i vetmi per me njoftë e me daa njanin koom prejë tjetrit...”³.

Artikulli vijon me vlerësimin ndaj gjuhës shqipe, dhe shpresën që të gjithë shqiptarët kishin te Komisia Letrare, që dijetarët që ishin të angazhuar mund t’i jepnin gjuhës shqipe drejtimin sa do e kishte pasë lakmi çdo gjuhë tjetër.

“Thonë se Komisioni paska pasë dra me hjekë n’skrim t’gjitha fjalve shqype sasiën a kuantitetin e zânoreve. Per njimii faqe t’bardha; por per n’kjoftë ky guri mâa⁴

“...Vendimi i Komisionit qy me hjekë sasiën e germave n’fjalë shqype, m’duket porsi nji bume (t’mfalet parasimi, por jena n’kohë lufte) m’duket si nji bume e vendosun nën pomendore letrare t’nji Bogdanit e t’nji Kristoforidit qy janë etent e gjithë shqype, si edhe pomendore t’madhnueshme qy kanë ngehë me dorë t’vet sidomos nja disa pjestarë t’Komisionit letrar, pse t’gjith, jo vetëm e kan marrë ‘n’kujdes sasiën e zânoreve, si lypte natyra e gjuhës, por edhe i kan dalë zot, me shkrimet e veta. Shkurt: T’hjekunt e sasiës s’zânoreve asht nji atentat qy i bâhet gjuhës shqype....”⁵

¹ Shih: T. Osmani, *Komisia Letrare Shkodër*, Shkodër, 2004, f. 15.

² Shih: T. Topalli, *Gazeta Posta e Shqypniës dhe Lambertz-i*, Tiranë, 2011, f. 16.

³ “Posta e Shqypniës”, 30. Dhetuer, 1916, f. 5.

⁴ “Posta e Shqypniës”, 30. Dhetuer, 1916, f. 5.

⁵ “Posta e Shqypniës”, 30. Dhetuer, 1916, f. 5.

Vlerësime për drejtshkrimin në shkrimet e gazetës *Posta e Shqypniës*

Shkrime me të tillë problematikë vijuan edhe në numrat pasardhës të gazetës.

- Intelektuali françeskan Atë Dedë Berdica, ngrihet jo veç kundër heqjes së kuantitetit të zanoreve por edhe kundër vendosjes së dialektit të Elbasanit për gjuhë të unifikuar me disa përmisime. Në rubrikën “Literatyrë e harte”, me datë 02.01.1917, botoi shkrimin me titull, “*Nji vëndim i Komisionit Letraar*”.

Në shkrim ai përdor edhe satirën “...Por Shqypnia asht msue me pasë drithë paa thasë, e me pasë thasë paa drithë: po due me thanë se asht fort për t’u drashtë se Komisioni, si asht sod me sod- sado qi pjestarët e tij marrun veçmas, meritojnë e jo veç ndere, por edhe uzdajë prejë komit – s’do të mund t’pergjigjet dishireve t’Naltes Komandë. Qe, bie fjala: janë pesë muej, qi asht ndertue Kl e qi komi, me gojë hapët po rrin tujë pritë palë se ç’fjalë t’urtë po qet Komisioni, e mas pesë muajsh punet. Komisioni po del e u thotë Shqyphtarve: Shqyphtarë ! a) gjuha shqype – ajo e bukra – nuk kaa kuantitet, a se, mos tjetër, kuantiteti nuk do qitë n’ortografisë. Po a nuk asht thue, rasa me të raa nder mend ajo fjala e vjetër, qi thotë: Parturiunt montes: orientur ridiculus mus? – Po pjellin malet: leen nji mii i percjellun.- Kû e din Komisioni Letraar se palci i gjûhës shqype kênka djalekti i Elbasanit, masi nuk kemi libra t’shkruem, thjesht n’at djalekt. – veç e n’u thirrët djalekt i Elbasanit gjûha e veprave t’Kristoforidhit, qi s’asht gjat tjetër veç gegnishte ⁶.

Shkrimi vazhdon me nota kritike ndaj këtij vendimi të Komisionit, ku sjell argumentin që të gjithë autorët e vjetër e në vazhdim kanë shkruar në gegërishte, e që tani Komisioni Letrar po e humbet hijeshinë që ka gjuha shqipe.

- Vendimi i Komisionit Letrar Shkodër, për heqjen e gjatësisë së zanoreve e cila do të shënohej vetëm në botimet gjuhësore, pati kundërshtime edhe nga dijetarë të tjerë, veçanërisht nga Hilë Mosi. Ai shkroi një artikull për këtë çështje, por edhe në mbledhjen e datës 24.09.1916, deklaroi që ishte kundër heqjes së kuantitetit dhe hundorësisë së zanoreve.

Shembuj të përdorur rëndomtë për dyfishin e zanoreve

- Në artikujt e botuar në gazetën “*Posta e Shqypniës*”, vërejmë, shumë të përdorur dyfishimin e zanoreve në fund të fjalë, por në disa raste edhe në trup të fjalës: psh. *Permi, trii, t’mdhaa, kaa, raa, mii, trashigimtaar, kaa daa, bâa, i rii, mâa, t’leemit, e gjâan, u daa, fiill, kuur, praa mii dheë, mâa, paa*⁷, *tii kaa nisë, koom, saa, praa, t’Tii, saa, raa, u bâa, baneë, gjâa, kalaa, zâam, prîi, bâa baall, t leemit, t’dhaa, t’rii, n’baall, shtyy, leet*⁸, me ja bâa mâa të leet, vjerrshëtaar etj.

*Mas nji lajmit krejt t’paprîtun e t’padishrueshem, qi na diftote se Italia kishte daa, paa vû u oroë aspak vëndimet e Shteteve tjera...*⁹.

*Ç’prejë se kaa fillue lufta, anmiku kaa djerrë 5.019.500 tonelatë ...*¹⁰

⁶ Gazeta “Posta e Shqypniës”, 3. Kallnduer, 1917, f. 4.

⁷ Gazeta “Posta e Shqypniës”, Shkodër, 17. Gusht 1917, nr. 73, f. 1.

⁸ Gazeta “Posta e Shqypniës”, Shkodër, 25. Gusht 1917, nr. 75, f. 3.

⁹ Gazeta “Posta e Shqypniës”, Shkodër, 16. Qersht 1917, nr. 55, f. 1.

¹⁰ Gazeta “Posta e Shqypniës”, Shkodër, 14. Prill 1917, nr. 37, f. 1.

Kuantiteti i zanoreve është një dukuri e cila paraqitet që në numrat e parë të gazetës e deri në numrat e fundit. Kjo ishte një dukuri gjuhësore e arealit gegë.

Shkrimet të cilat u botuan në faqet e gazetës “*Posta e Shqypniës*”, përkatësisht në rubrikën “*Literatyrë e harte*”, për vlerësimin e drejtshkrimit të gjuhës shqipe, ishin shkrime të argumentuara jo rrallë herë mbi baza shkencore.

KONKLUZIONE

Gazeta “*Posta e Shqypniës*”, ka luajtur rol të rëndësishëm për unifikimin e gjuhës shqipe, duke filluar nga disa vlerësime për drejtshkrimin e gjuhës shqipe dhe duke vazhduar me shkrime të gjata shkencore. Norma drejtshkimore që zbatonte, kishte gjithnjë prirje nga *unjisimi i gjuhës së shkruar* të variantit më të mirë e të përparuar gegë.

Gazeta që në muajin e parë nxori lajme për vendimet e Komisionit Letrare. Por përveç vendimeve të Komisionit Letrare, në faqet e kësaj gazete e pikërisht në rubrikën “*Literatyrë e harte*”, botohen shkrime kundër vendimeve të Komisionit Letrare.

U shkruan disa artikuj kundër vendimit të Komisionit Letrare Shkodër, për heqjen e gjatësisë së zanoreve e cila do të shënohej vetëm në botimet gjuhësore, si dhe kundër vendosjes së dialektit të Elbasanit për gjuhë të unifikuar me disa përmirë sime.

BIBLIOGRAFI

E. Çabej, *Studime gjuhësore V*, Prishtinë, 1975.

Fjalori enciklopedik Shqiptar, Tiranë, 2008.

Posta e Shqypniës, Shkodër, 1916- 1918.

T. Topalli, *Maksimilian Lambertz-i dhe gazeta “Posta e Shqypniës”*, Buletini Shkencor, Universiteti “Luigj Gurakuqi”, 2009.

T. Topalli, *Posta e Shqypniës dhe Lambertz-i*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 2011.

T. Osmani, *Komisioni Letrare e Shkodrës*, Shkodër, 2004.